



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Nr. 2100/13 Prot.

Tiranë, më 12.12.2024

Lënda: Kërkesë për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike të datës 16.12.2024

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK

Tiranë

Në zbatim të Kreut II pika 13 e VKM nr. 425, datë 27.5.2020 “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore” i ndryshuar, dhe Lidhjes 1, Shtojca 1 e Udhëzimit të Ministrit të Kulturës nr. 269 datë 11.08.2020 i ndryshuar, bashkëlidhur po ju dërgojmë për publikim “FORMULARI I NJOFTIMIT TË KONKURRIMIT PUBLIK”.

Njoftimi ju dërgohet edhe në format elektronik (CD) si dhe në adresën zyrtare të emailit – info@app.gov.al.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM
SOKOL ISMAILI**





FORMULARI I NJOFTIMIT TË KONKURRIMIT PUBLIK

1. Institucioni/Autoriteti Kontraktor - **Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Tiranë** njofton subjektet e interesuara të licencuara në zbatim, në pasuritë kulturore të marrin pjesë me ofertat e tyre publike në konkurrimin publik të shpallur nga ky institucion.
2. Emërtimin dhe vendndodhjen e objektit: **“RESTAURIM BANESA E MUSTAFA SHEHUT, ZERQAN, BULQIZË”**, Monument Kulture i kategorisë së I-rë.
3. Llojin e punës: **“RESTAURIM BANESA E MUSTAFA SHEHUT, ZERQAN, BULQIZË”**.
4. Fondi limit i procedurës së konkurrimin **5.182.500** (pesë milion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e pesëqind), **lekë pa TVSH**, sipas preventivit të punimeve të miratuar në KKTKM.
5. Afati i realizimit të kontratës **180 ditë**, nga data e lidhjes së kontratës.
6. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është **jo më pak se 8 ditë nga publikimi** i këtij njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit Kontraktor, përkatësisht data **24.12.2024 ora 09:00**, në zyrën e protokollit të institucionit, me Adresë Rr. “Aleksandër Moisiu” Nr. 76, ish Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë, Shqipëri. Ofertat e paraqitura pas këtij afati do të refuzohen.
7. Afati dhe mënyra për tërheqjen e dokumenteve të konkurrimin publik: Kandidatët e interesuar mund të aksesojnë dokumentet standarde të konkurrimin publik në faqen zyrtare të Autoritetit Kontraktor: www.iktk.gov.al në Rubrikën “Rreth nesh/Njoftime”.
8. Ofertat duhet të shoqërohen nga dokumente ligjorë dhe administrative origjinale ose kopje të noterizuara si provë e plotësimit të kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dokumentet standarde, të miratuara për këtë qëllim.
9. Hapja e ofertave nga Njësia e vlerësimit do të jetë në datë **24.12.2024 ora 10:00** në Autoritetin Kontraktor/Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Tiranë, kati II, salla e Bibliotekës, dhe do të shqyrtohen brenda afatit prej 7- ditësh nga data e hapjes së tyre.
10. Ofertuesit apo Përfaqësues të autorizuar me shkrim të tyre mund të jenë të pranishëm në datën, orën dhe vendin e hapjes së ofertave.